



REPUBLIKA E SHQIPERISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 527/2 Prot

Tiranë, më 5.4 2012

VENDIM

Nr. 09, datë 05/04 2012

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr. 211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale", pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit *Univers-ALB sh.a.*,

KONSTATOVA

Sipas ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", ju keni cilësinë e Kontrolluesit, pra përgjegjësinë për përpunimin e të dhënave personale dhe si i tillë keni detyrimin të zbatoni të gjitha kërkesat e këtij ligji.

Në zbatim të Urdhërit nr.25, datë 05.03.2012 pranë kontrolluesit, *Univers-ALB sh.a* është realizuar kontrolli administrativ nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe konkretisht:

Objekti i kontrollit ishte:

➤ **Verifikimi i zbatimit të Rekomandimit të Komisionerit Nr.24/2, datë 04.07.2011, dhënë ndaj kontrolluesit në lidhje me:**

- Verifikimin nëse kontrolluesi ka plotësuar të gjitha mangësitë në procesin e njoftimit-regjistrimit, nëpërmjet Formularit të Njoftimit (sipas pikës 1 të Rekomandimit të sipërcituar);

Nga Komisioneri u verifikua se detyrimi ligjor sipas neneve 21,22 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", nuk është përmbushur nga kontrolluesi sipas afatit ligjor të vendosur në Rekomandim dhe deri në momentin e kryerjes së kontrollit administrativ.

- Verifikimin nëse kontrolluesi ka miratuar dhe zbaton Rregulloren e posaçme "Për mbrojtjen e të dhënave personale", duke përfshirë rregulla për sigurinë e të dhënave dhe konfidencialitetin (sipas pikës 1 të këtij Rekomandimi);

Në lidhje me këtë pikë të Rekomandimit nga grupi i inspektimit u konstatua dhe verifikua se: Kontrolluesi nuk kishte filluar asnjë procedurë për hartimin e Rregullores me të gjitha elementet të përshkruara në Rekomandim. Gjithashtu nga kontrolluesi nuk u vu në

dispozicion asnjë provë që të vërtetonte të kundërtën apo të vërtetonte që hartimi i rregullores ishte në proces pune nga Departamenti Përgjegjës.

- Verifikimin nëse kontrolluesi ka parashikuar të dhëna opsionale, ka hequr të dhënat e klasifikuara të tepërta, si dhe nëse ka shtuar rubrikën për informimin e subjekteve të të dhënave personale, në Formularin e Aplikimit për Punësim (sipas pikës 3 të Rekomandimit)

Në lidhje me këtë pikë të Rekomandimit nga grupi i inspektimit u konstatua se asnjë nga këto pika nuk ishte plotësuar dhe reflektuar në Formularin e Aplikimit për punë nga ana e kontrolluesit. Vetëm datën e mbylljes së procesverbalit 20/03/2012 kontrolluesi është vënë menjëherë në lëvizje për ndryshimin e këtij Formulari sipas rekomandimit.

Megjithatë në pjesën e fundit të Formularit është konstatuar se ende nuk janë plotësuar në Formën e duhur sipas Rekomandimit, pasi nuk janë reflektuar në mënyrë eksplicite nenet 12-17 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të dhënave personale”. Ky mbetet një detyrim për tu përmbushur përsëri nga kontrolluesi.

Duke patur parasysh, se Rekomandimet e Komisionerit janë të detyrueshme për tu zbatuar nga kontrolluesit të cilëve ju drejtohen. Rekomandimi që del nga Autoriteti i Komisionerit është një prej formave, që u vjen në ndihmë kontrolluesve për t'i vënë në dijeni në lidhje me detyrimet e përmbushura nga ana e tyre në zbatim të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

Sipas nenit 30 pika 2, të ligjit “Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”.

Për zgjedhjen e masës së gjobës Komisioneri ka parasysh shkallën e njohjes dhe masat që kenë marrë për implementimin e ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Nisur sa më sipër, në zbatim të nenit 21-23, 27, 30/2, 39/1,4; 40 e 41, të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, neneve 107-109 të K.Pr.Administrative, si dhe Nenit 18/a, c të Ligjit Nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative”:

V E N D O S A

1. Dënimin e Kontrolluesit, **Univers-Alb sh.a.**, me gjobë 10 000 (dhjetëmijë) lekë për mospërmbushjen e detyrimit për njoftim pranë Komisionerit;
2. Dënimin e Kontrolluesit, **Univers-Alb sh.a.**, me gjobë 15 000 (pesëmbëdhjetëmijë) lekë për mos-hartim dhe vënien në zbatim të Rregullores për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
3. Plotësimin e mangësive të konstatuara në Formularin e Aplikimit për punë, në lidhje me pjesën e fundit të tij, që ka lidhje me reflektimin eksplicit të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “ Për mbrojtjen e të dhënave personale” sipas pjesës arsyetuese të këtij vendimi, brenda një afati kohor prej 5 (pesë) ditësh.
4. Bazuar në nenet 21-22 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të realizoni plotësimin e njoftimit për përpunimin e të dhënave, brenda një afati prej 5 (pesë) ditësh;

5. Bazuar në nenet 27/2 "c" dhe 28 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", të hartoni Rregullore të Brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin, brenda një afati prej 20 (njëzet) ditësh. Zyra e Komisionerit ofron asistencën e saj për hartimin e këtij akti.
6. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky vendim shndërrohet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbartimit.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit.

Ky vendim u dha sot më datë, 05.04.2012.

KOMISIONERI

Flora ÇABEJ (Pogaçe)

